

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS

BYROJA E ZHVILLIMIT TË ARSIMIT



Programi mësimor

ARSIM FIGURATIV

për klasën e II

Shkup, 2021

TË DHËNAT ELEMENTARE PËR PROGRAMIN MËSIMOR

Lënda mësimore	<i>Arsimi figurativ</i>
Lloji/kategoria e lëndës mësimore	I detyrueshëm
Klasa	II (e dytë)
Tema/fusha në programin mësimor	<ul style="list-style-type: none"> • <i>Vizatim</i> • <i>Pikturë</i> • <i>Modelimi dhe ndërtimi i plastikës</i> • <i>Printimi dhe dizajni</i>
Numri i orëve	1 orë në javë/ 36 orë në vit
Pajisjet dhe mjetet	<ul style="list-style-type: none"> • Mjete audiovizive: TV, DVD player, projektor LCD, kasetofon, aparat fotografik digjital, kamerë digjitale, kompjuter, tabletë inteligjente, tabletë vizatimi, printer ose pajisje të tjera digjitale. • Internet, softuer arsimor. • Mjetet dhe materialet për vizatim (letër, letër me ngjyra, laps, ngjyra druri, pastelat, shkumësa, markerë, materiale natyrore dhe artificiale, kavaleta). • Mjete vizuale (vizatime, piktura, fotografi, punime, revista, postera, aplikacione, ilustrime, prospekte, muze, ekspozita arti etj.). • Mjetet dhe materialet e pikturimit (ngjyra uji, bllok, furça, letër hamer, ngjyra tempere, pastel, paleta, letra me ngjyra, materiale natyrore dhe artificiale). • Mjete dhe materiale për formimin dhe ndërtimin e plastikës (plastelinë, miell, brumë, argjilë, rërë, borë, stiropor, plastikë etj.). • Mjetet dhe materialet për printim (vula, shabllone dhe materiale për prodhimin e shablloneve, karton, ngjyra ekologjike, fruta, karton-vulë, shabllon, materiale natyrore dhe artificiale etj.). • Mjetet dhe materialet e dizajnit (fotografi, zbuquime, bizhuteri, çarçaf, peceta, letër muri, ilustrime, gërshërë, ngjitës etj.) • Materiale jo kreative (krehër, furça dhëmbësh, make-up, manikyr, qiri, sapun, çadër,

	kapele, gur, gazë, CD, shtrydhëse frutash, perime dhe fruta, tekstile, gota, pjata etj.).
Normativi i kuadrit arsimor	Puna edukative - arsimore në klasën e dytë mund të kryhet nga një person që ka titullin: <ul style="list-style-type: none"> • Profesor i mësimit klasor, VII / 1 ose VI / 1 (sipas KMK-së) dhe 240 SETK; • Pedagog i diplomuar, VII / 1 ose VI / 1 (sipas KMK-së) dhe 240 SETK.

LIDHSHMËRIA ME STANDARDET KOMBËTARE

Rezultatet e të mësuarit të paraqitura në programin mësimor shpiejnë drejt përvetësimit të kompetencave në vijim të përfshira në fushën e **Shprehjes artistike dhe kulturore** nga Standardet Kombëtare:

<i>Nxënësi/nxënësja di dhe/ose mund:</i>	
VIII-A.1	të manifestojë njohuri për forma të ndryshme të shprehjes artistike nga të gjitha fushat e kulturës (letërsi, muzikë, arte vizuale, arte skenike, arte dekorative, arkitekturë, dizajn);
VIII-A.2	të identifikojë manifestimet e ndryshme të kulturës popullore dhe ndikimin e tyre në zhvillimin e vlerave estetike;
VIII-A.3	të shprehë idetë, përvojat dhe emocionet e veta, duke përdorur forma artistike ose forma të tjera të shprehjes krijuese (individuale ose kolektive);
VIII-A.5	të manifestojë njohuri për kulturën e vet dhe mënyrat e ndryshme të shprehjes së saj nëpërmjet letërsisë dhe arteve vizuale, muzikës dhe vallëzimit, objekteve dhe produkteve të tjera kulturore;
VIII-A.6	t'i identifikojë dallimet dhe ngjashmëritë ndërmjet kulturës së vet dhe kulturave të tjera në mjedisin e tij/saj më të ngushtë e më të gjerë për të analizuar lidhjen dhe ndërvarësinë e tyre.
<i>Nxënësi/nxënësja pranon se:</i>	
VIII-B.2	qëndrimi kritik ndaj produkteve të ndryshme të artit është i rëndësishëm për zhvillimin e vlerave estetike individuale dhe sociale;
VIII-B.3	respektimi dhe promovimi i kulturës së vet kontribuon në forcimin e identitetit dhe dinjitetit kulturor;
VIII-B.6	respektimi dhe promovimi i kulturave të tjera kontribuon në sigurimin e respektimit të kulturës së vet nga ana e të tjerëve.

Programi arsimor përfshin kompetencat përkatëse në fushat e mëposhtme të Standardeve Kombëtare:

Shkrim-leximi, zhvillimi personal dhe social, shoqëria dhe kultura demokratike, teknika, teknologjia dhe sipërmarrësia:

<i>Nxënësi/nxënësja di dhe mund:</i>	
IV-A.2	të vlerësojë se kur dhe në çfarë mënyre përdorimi i TIK-ut është i nevojshëm dhe efektiv për zgjidhjen e një detyre/problemi;

IV-A.5	të përcaktojë se çfarë informacioni i nevojitet atij/asaj, të gjejë, të zgjedhë dhe të shkarkojë të dhëna digjitale, informacione dhe përmbajtje digjitale;
V-A.1	të dallojë stilin e jetës së shëndetshme nga ajo e rrezikshme kur bëhet fjalë për të gjitha sferat e jetës (duke përfshirë shprehitë e të ngrënit, sportet dhe aktivitetet rekreative);
V-A.2	të zgjedhë dhe praktikojë aktivitete që sigurojnë zhvillimin dhe përmirësimin e shëndetit të tij/saj mendor dhe fizik;
V-A.4	t'i vlerësojë aftësitë dhe arritjet e tij/saj (përfshirë pikat e forta dhe të dobëta) dhe në bazë saj të përcaktojë përparësitë që do të mundësojnë zhvillimin dhe përparimin e atij/asaj;
V-A.5	të njohë emocionet tek vetja dhe tek të tjerët;
V-A.6	të vendosë qëllime për mësim dhe vetëzhvillim dhe të punojë për të tejkaluar sfidat që dalin gjatë rrugëtimit drejt arritjeve të tij/saj;
V-A.7	t'i përdorë përvojat e veta për të lehtësuar mësimin dhe për të rregulluar sjelljen personale në të ardhmen;
V-A.13	të komunikojë me të tjerët;
V-A.14	të dëgjojë në mënyrë aktive dhe të reagojë në mënyrë të përshtatshme duke treguar ndjeshmëri dhe mirëkuptim për të tjerët dhe duke shprehur shqetësimet dhe nevojat e veta në një mënyrë konstruktive;
V-A.15	të bashkëpunojë me të tjerët në arritjen e qëllimeve të përbashkëta, duke ndarë pikëpamjet dhe nevojat e tyre me të tjerët dhe duke marrë parasysh pikëpamjet dhe nevojat e të tjerëve;
V-A.17	të kërkojë informatë kthyesë dhe mbështetje për veten, por gjithashtu ta kthejë informatën në mënyrë konstruktive dhe mbështetëse në dobi të të tjerëve;
V-A.19	të propozojë, të shqyrtojë mundësi të ndryshme dhe të parashikojë pasojat në mënyrë që të nxjerr konkluzion dhe të marrë vendime racionale;
VI-A.5	t'i kuptojë ndryshimet midis njerëzve për çfarëdo baze (gjinia dhe përkatësia etnike, mosha, aftësitë, statusi shoqëror etj.);
VI-A.6	ta njohë praninë e stereotipeve dhe paragjykimëve te vetja dhe te të tjerët dhe të kundërshtojë diskriminimin;
VI-A.7	të njohë manifestimin e dhunës verbale dhe fizike në mjedisin e tij/saj, të perceptojë pasojat e dhunës dhe ta kundërshtojë atë;
VI-A.8	të shohë se çfarë i lidh dhe çfarë i ndan njerëzit në komunitet, që të gjetjë mënyra për të kontribuar në përparimin e komunitetit, duke marrë parasysh nevojat dhe interesat e të gjithëve;
VI-A.11	të zbatojë rregullat dhe rregulloret për pjesëmarrje të sigurt në komunikacion;
VI-A.22	të identifikojë dhe respektojë të gjitha simbolet nacionale të shtetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe të manifestojë ndjenjën e përkatësisë ndaj shtetit;
VII-A.4	të gjenerojë ide dhe të projektojë aktivitete që çojnë në produkte dhe/ose shërbime;
VII-A.9	të merr pjesë në mënyrë aktive në punën e ekipit sipas rregullave të miratuara më parë dhe me respekt të vazhdueshëm për rolin dhe kontributin e të gjithë anëtarëve të ekipit.
<i>Nxënësi/nxënësjë kupton dhe pranon që:</i>	
IV-B.1	shkrim-leximi digjital është i nevojshëm për jetën e përditshme - lehtëson të mësuarit, jetën dhe punën, kontribuon në zgjerimin e komunikimit, krijimtarisë dhe inovacionit, ofron mundësi të ndryshme për argëtim;

V-B.1	kujdesi për trupin dhe aktiviteti i rregullt fizik është kusht i rëndësishëm për sigurimin e shëndetit fizik dhe mendor;
V-B.2	njohja e identitetit të vet kontribuon në forcimin e vetëbesimit dhe zhvillimin e personalitetit;
V-B.3	arritjet dhe mirëqenia personale kryesisht varen nga puna që ai/ajo investon dhe rezultatet që ai/ajo arrin;
V-B.4	çdo veprim që ai/ajo ndërmerr ka pasoja për të dhe/ose mjedisin e tij/saj;
V-B.7	iniciativa, këmbëngulja, qëndrueshmëria dhe përgjegjësia janë të rëndësishme për zbatimin e detyrave, arritjen e qëllimeve dhe tejkalimin e sfidave në situatat e përditshme;
V-B.8	bashkëveprimi me të tjerët është i dyanshëm - siç ka të drejtë të kërkojë nga të tjerët që t'i mundësojnë atij/asaj që të jetë i/e kënaqur me interesat dhe nevojat e tij/saj, ashtu edhe ai/ajo ka përgjegjësi t'u japë hapësirë të tjerëve për të përmbushur interesat dhe nevojat e tyre;
V-B.9	kërkimi i informatave kthyesë dhe pranimi i kritikave konstruktive shpiejnë në përparim personal në nivel individual dhe shoqëror;
VI-B.13	identiteti kombëtar, i cili buron nga përkatësia e shtetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, është komponent i rëndësishëm i identitetit të të gjithë qytetarëve të vendit.

REZULTATET E TË NXËNIT

<p>Tema: VIZATIM Gjithsej: 10 orë</p> <p>Rezultatet e të nxënit</p> <p>Nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë të:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. aplikojë baza, vegla dhe materiale të ndryshme në vizatim; 2. krijojë një vizatim, duke përdorur elementet artistike: madhësinë, hapësirën, tonin dhe sipërfaqen; 3. vizatojë sende, personazhe dhe dukuri të njohura nga mjedisi ku jeton dhe mëson. 4. të bëjë vizatime në kompjuter. <p>Nxënësi/nxënësja do të:</p> <ol style="list-style-type: none"> 5. zhvillojë imagjinatën nëpërmjet vizatimit;

6. zhvillojë dhe kultivojë shprehje të lira dhe pa kufizime të punës.

Përmbajtjet (dhe konceptet)	Standardet për vlerësim
<ul style="list-style-type: none"> Bazat, mjetet dhe materialet për vizatim dhe përdorimi i tyre (letër, letër me ngjyra, laps, ngjyra druri, shkumës, pastela, markerë, materiale natyrale dhe artificiale) 	<ul style="list-style-type: none"> Përdor baza, mjete dhe materiale të shumëllojshme për vizatim. Krahason dhe dallon vizatimet sipas bazës, mjeteve dhe materialeve të përdorura. Vizaton vija të ndryshme duke kombinuar mjete dhe materiale të ndryshme
<ul style="list-style-type: none"> Terminologjia artistike në vizatim (pika, vija - e hollë / e trashë, e gjatë / e shkurtër, e lakuar / e drejtë, zigzag, ngjyra, drejtimi, forma, madhësia, hapësira - përpara / mbrapa, lart / poshtë, majtas / djathtas, toni - i lehtë / i errët, sipërfaqja - e lëmuar / e vrazhdë, e fortë / e butë, hije, detaj, intensitet, saktësi) 	<ul style="list-style-type: none"> Shpjegon vizatimet nëpërmjet terminologjisë artistike. Vizaton duke përdorur elementet e artit: madhësinë, hapësirën, tonin dhe sipërfaqen. Përdor lloje të ndryshme lapsash për të arritur saktësi në vizatim. Bën një vizatim të tërë duke përdorur detaje. Arrin një efekt dritë-errësi duke përdorur teknikën Shading në vizatim. Bën vizatime në kompjuter (për shembull: shkollë, shtëpi, personazh i preferuar, vendbanim etj.).
<p>Shembuj të aktiviteteve</p> <ul style="list-style-type: none"> Nxënësit vizatojnë duke marrë si temë <i>Shiu</i> me ndihmën e vijave të holla, të trasha, të gjata dhe të shkurtra. Ata përdorin edhe një pikë si një element të rëndësishëm krijues. Materialet e përdorura për këtë detyrë janë: lapsa me trashësi të ndryshme, argjil dhe tush. Nxënësit vizatojnë me markerë të hollë dhe të trashë në temën <i>Rruga për në shkollë ose Rruga për në shtëpinë time</i> dhe përdorin vija të lakuara. Nxënësit bëjnë një vizatim me temën <i>Gjethet e vjeshtës</i> me trashësi të ndryshme lapsash, qymyr druri dhe tush. Ata përdorin vija të lakuara me trashësi të ndryshme dhe gjatësi të ndryshme. Nxënësit bëjnë një vizatim me temë <i>Natyra e vdekur</i> duke përdorur si model madhësi të ndryshme kuti kartoni. Ata përdorin vija të lakuara dhe të drejta me trashësi të ndryshme dhe gjatësi të ndryshme. Nxënësit bëjnë një vizatim me temën <i>Hapësira rreth meje</i> me lloje të ndryshme vijash (të holla, të gjata, të shkurtra, të lakuara, të drejta, zigzage), pika në një drejtim të caktuar e të ngjashme. Mësimdhënësi organizon një lojë në të cilën nxënësit përdorin kuti kartoni të madhësive të ndryshme, të cilat kanë hapësirë të mjaftueshme që nxënësit të mund të hyjnë në to dhe të ndjejnë hapësirën. Kur kutitë mbyllen, brenda është errësirë dhe kur hapen është dritë. Nxënësit duke zbatuar ritmin në rresht, dekorojnë vetë kutitë me paste le sipas dëshirës së tyre. 	

- Nxënësit vizatojnë bizhuteri me laps dhe ngjyra druri dhe duke hijezuar detajet krijojnë një tërësi.
- Nxënësit vizatojnë në kompjuter një semafor me vija me trashësi të ndryshme.
- Nxënësit vizatojnë një motiv nga shtëpia dhe/ose shkolla në forma gjeometrike me vija konturore dhe hije.
- Nxënësit në oborrin e shkollës me shkumësa me ngjyra vizatojnë vija me forma të ndryshme të mjedisit dhe përcaktojnë termat: para/mbrapa, lart/poshtë, majtas/djathtas.

Tema: **PIKTURË**

Gjithsej: **14 orë**

Rezultate e të nxënit

Nxënësi/nxënësja do të aftësohet të:

1. aplikojë në pikturë baza, mjete dhe materiale të ndryshme;
2. krijojë një pikturë, duke përdorur elementet artistike: madhësinë, hapësirën, tonin dhe sipërfaqen;
3. pikturojë objekte, personazhe dhe dukuri nga mjedisi ku jeton dhe mëson;
4. dallojë ngjyrat sekondare dhe të shprehet në mënyrë krijuese me to;
5. përdorë kompjuterin në pikturë.

Nxënësi/nxënësja do të:

6. zhvillojë kreativitet nëpërmjet pikturës;
7. zhvillojë dhe kultivojë shprehitë higjienike-teknike dhe shprehitë e punës.

Përmbajtjet (dhe konceptet)	Standardet për vlerësim
<ul style="list-style-type: none"> • Bazat, mjetet dhe materialet për pikturim dhe përdorimi i tyre (ngjyra uji, bllok, furça, letër hamer, ngjyra tempere, pastel, kolazh, paleta, letër me ngjyra, ngjitës, gërshërë, materiale natyrore, materiale artificiale...) 	<ul style="list-style-type: none"> • Përdor një shumëllojshmëri të bazave, mjeteve dhe materialeve në pikturim. • Krahason dhe dallon pikturat e punuara me mjete, materiale dhe teknika të ndryshme. • Pikturon dhe bën një kolazh duke kombinuar baza, mjete dhe materiale.
<ul style="list-style-type: none"> • Gjuha e artit në pikturë (madhësia, hapësira, toni, sipërfaqja, dizajni) 	<ul style="list-style-type: none"> • Përshkruan pikturat duke përdorur terminologjinë e përshtatshme artistike. • Pikturon duke zbatuar elementet artistike: madhësinë, hapësirën, tonin dhe sipërfaqen. • Përdor teknika të ndryshme të pikturimit të dezeneve. • Përdor detajet në pikturë dhe formon një tërësi.

- Ngjyrat dhe nuancat sekondare (portokalli, vjollcë, gjelbër)

- Njih dhe emërton ngjyrat sekondare dhe nuancat e tyre.
- Fiton ngjyra sekondare duke përzier ngjyrat primare.
- Përdor ngjyrat sekondare dhe nuancat e tyre për të pikturuar personazhe, sende dhe objekte që lidhen me shtëpinë, shkollën dhe vendbanimin.
- Krijon një kolazh duke aplikuar ngjyra sekondare nga materiale natyrore dhe artificiale.
- Pikturon në kompjuter, duke përdorur ngjyrat primare dhe sekondare dhe nuancat e tyre.

Shembuj të aktiviteteve

- Nxënësit pikturojnë fishekzjarrë. Ngjyrat primare, ngjyrat sekondare dhe sipërfaqja përdoren si mjete shprehëse. Tempera dhe pastel në kombinim përdoren si material arti. Paraqiten shembuj nga Van Gogh - **Nata me yje ("The Starry Night")**
- Nxënësit pikturojnë në temën e caktuar p.sh. **Dhoma ime**. Ngjyrat sekondare dhe hapësira përdoren si mjete shprehëse. Materiali artistik i përdorur - tempera dhe pastel në kombinim. Paraqiten shembuj nga Van Gogh-u.
- Nxënësit pikturojnë në temën e caktuar **Dritarja në klasën time**. Mësohet termi hapësirë dhe përdoren ngjyrat primare dhe sekondare. Materiali artistik i përdorur – ngjyra uji. Paraqiten shembuj nga Rene Magritte.
- Gjysma e nxënësve pikturojnë në temën **Shkolla ime** duke përdorur ngjyrat sipas zgjedhjes së tyre. Gjysma tjetër pikturon në të njëjtën temë, por vetëm me ngjyrë të bardhë dhe të zezë. Pas prezantimit të vizatimeve, ata bashkërisht diskutojnë se si kompozime të ndryshme ngjyrash përcjellin mesazhe të ndryshme.
- Nxënësi pikturon një **vazo me motive të luleve**. Përdor: ngjyrat e ngrohta, tonet dhe sipërfaqen si mjet shprehës dhe nocionin në terminologjinë artistike. Materiali artistik i përdorur - tempera dhe pastel në kombinim. Paraqiten shembuj nga Van Gogh - **Luledielli**.
- Nxënësit pikturojnë një motiv **pranveror**. Ngjyrat e ftohta, tonet dhe sipërfaqet përdoren si mjete shprehëse. Materiali artistik i përdorur - tempera dhe pastel në kombinim. Paraqiten shembuj nga Van Gogh - **Lulet e qershisë**.
- Nxënësit pikturojnë **fruta**. Si mjete shprehëse përdoren këto ngjyra: ngjyrat primare dhe sekondare, madhësia dhe forma. Materiali artistik i përdorur – ngjyra uji dhe pastel në kombinim. Paraqiten shembuj nga piktori Paul Cézanne.
- Nxënësit pikturojnë një **motiv në oborrin e shkollës** sipas idesë së tyre. Ngjyrat sekondare përdoren si material arti për të fituar njohuri për termat: hapësirë, sipërfaqe, madhësi. Paraqiten shembuj të peizazheve nga Cézanne.
- Nxënësit me teknikën **Kolazh** bëjnë kartolina me motive nga stinët me materiale natyrore dhe artificiale: gërshërë, ngjitës, pe, tel, pëlhurë, lule, gjethe, fara, karton etj.
- Nxënësit përdorin aplikacione të ndryshme kompjuterike për të parë se si përzihen ngjyrat primare dhe si fitohen ngjyrat sekondare. Më pas ata bëjnë një pikturë kompjuterike me ngjyra të ngrohta, të ftohta dhe nuancat e tyre.

Tema: **MODELIMI DHE NDËRTIMI I PLASTIKËS**

Gjithsej: **5 orë**

Rezultate e të nxënit:

Nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë të:

1. bëjë figura të ndryshme nga materiale natyrore dhe artificiale për modelim;
2. përdorë teknika të ndryshme (prerje, ngjitje, palosje, bashkim, origami etj.) në modelimin e plastikës;
3. të modelojë forma tredimensionale dhe të ndërtojë figura të ndryshme nga materiale të ndryshme;
4. përdorë kompjuterin në modelimin dhe ndërtimin e plastikës.

Nxënësi/nxënësja do të:

5. zhvillojë aftësitë sensomotorike;
6. zhvillojë kreativitetin nëpërmjet modelimit dhe ndërtimit të plastikës;
7. fitojë shprehje higjieno-teknike dhe të punës.

Përmbajtjet (dhe konceptet)	Standardet për vlerësim
<ul style="list-style-type: none">• Bazat, mjetet dhe materialet për modelimin dhe ndërtimin e plastikës dhe përdorimi i tyre (argjilë, baltë, plastelinë, miell, brumë, materiale natyrore dhe artificiale)	<ul style="list-style-type: none">• Identifikon mjete dhe materiale të ndryshme për formësimin, modelimin dhe ndërtimin.• Dallon forma dhe struktura të ndryshme.• Përdor dhe kombinon mjete dhe materiale të ndryshme për të krijuar forma dhe struktura.
<ul style="list-style-type: none">• Gjuha e artit në modelimin dhe ndërtimin e plastikës (formësim plastik, modelim, ndërtim, formë tredimensionale, madhësi, hapësirë, ton, sipërfaqe, formë, skulpturë, figurë, model, material i ricikluar/mbeturina, mbështjellja)	<ul style="list-style-type: none">• Modelon dhe ndërton forma tredimensionale.• Përdor kompjuterin në modelimin dhe ndërtimin e plastikës.• Krijon formë ose strukturë duke përdorur elementë të artit: madhësinë, hapësirën, tonin dhe sipërfaqen.• Bën dallimin ndërmjet modelimit, formësimit dhe ndërtimit.• Modelon dhe ndërton në mënyrë të pavarur figura të ndryshme nga materiale të ndryshme.

Shembuj aktivitetesh

- Nxënësit modelojnë bizhuteri duke përdorur materiale që mund të gjenden në natyrë. Lidhshmëri me termat: forma, madhësia, ngjyra, toni.
- Nxënësit bëjnë dekorime ose zbukurojnë karamelë për një rast festiv, duke përdorur materiale të ndryshme. Përdoret: forma, ngjyra dhe sipërfaqja.
- Nxënësit formojnë kafshë me plastelinë, baltë ose argjil me temë *Kopshti Zoologjik* (elefant, gjirafë, krokodil, zog, peshk, nëpërmjet të cilëve bëhet lidhshmëria me termat: madhësia, forma, sipërfaqja, ngjyra).
- Nxënësit bëjnë një skulpturë të një **aeroplani** duke përdorur sende jofunksionale ose të vjetra, fitojnë njohuri dhe përvojë për kuptimin dhe përdorshmërinë e sendeve dhe kanë lidhshmëri me termat: formë, sipërfaqe, madhësi.

- Nxënësit, të ndarë në grupe, ndërtojnë modele me forma tredimensionale me temë *Shtëpia ime, shkolla ime, vendi im*, duke përdorur si material artistik: kuti kartoni, gërshtë, letra me ngjyrë, ngjitës dhe markerë. Nëpërmjet lojës, nxënësit lidhin ndërtimin me elementet artistike: formën, madhësinë, hapësirën dhe sipërfaqen.
- Nxënësit bëjnë mbështjelljen e frutave dhe bëjnë lidhje me formën, madhësinë etj.
- Nxënësit bëjnë rroba për shfaqje nga letra të vjetra, tekstile dhe qese të përdorura me ngjyra. Kuptojnë domethënien e termave: materiale mbetje, riciklim, përzgjedhje të mbetjeve.

Tema: **PRINTIMI DHE DIZAJNI**

Gjithsej: **7 orë**

Rezultate nga mësimi

Nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë të:

1. bëjë shabllone printimi dhe të printojë në mënyrë të pavarur me një kombinim printimesh (krijon një model/dekorim);
2. printojë duke përdorur kompjuter dhe printer;
3. dizajnojë, stolisë, bëjë bizhuteri dhe zbukurim, duke përdorur elemente, mjete dhe materiale të ndryshme artistike për dizajn;
4. dizajnojë, duke përdorur kompjuter ose telefon modern (smartphone).

Nxënësi/nxënësja do të:

5. zhvillojë aftësitë sensomotorike;
6. zhvillojë kreativitetin nëpërmjet printimit dhe dizajnit;
7. zhvillojë dhe kultivojë shprehitë higjienike – teknike dhe shprehitë e punës.

Përmbajtja (dhe nocionet)	Standardet e vlerësimit
<ul style="list-style-type: none"> • Baza, mjete dhe materiale printuese dhe përdorimi i tyre (printim, baza, materiale dhe pajisje printimi, printim kartoni, shabllon, materiale natyrore dhe artificiale, letër dhe printer). 	<ul style="list-style-type: none"> • Përdor baza natyrore dhe artificiale, materiale dhe ngjyra në printim. • Dallon dhe krahason printimet, bazat dhe shabllonët. • Përdor kompjuter dhe aparat për printim.
<ul style="list-style-type: none"> • Gjuha e artit në printim (printim, gjurmë, model, dekorim, monotip, kompozim). 	<ul style="list-style-type: none"> • Bën modele/zbukurime duke përsëritur printime të njëjta ose të ndryshme. • Zbaton elementet artistike: madhësinë, hapësirën, tonin dhe sipërfaqen në printim. • Krijon një printim/monotip grafik. • Kombinon shabllone dhe krijon kompozime të ndryshme.
<ul style="list-style-type: none"> • Mjetet dhe materialet për dizajn dhe përdorimi i 	<ul style="list-style-type: none"> • Identifikon dhe përdor një shumëllojshmëri mjetesh dhe materialesh dizajnimi.

<p>tyre (letër,ngjyra, pëlhurë, materiale ekologjike, materiale natyrore dhe artificiale, kompjuter, foto-aparat, gërshërë, ngjitës).</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Dallon dhe krahason dizajnet sipas materialeve nga të cilat janë bërë.
<ul style="list-style-type: none"> • Terminologjia artistike në dizajn • (dizajn, dezen, stoli, bizhuteri, dekorim, fotografi, ilustrime, ballina etj.) 	<ul style="list-style-type: none"> • Dizajnon duke aplikuar dhe kombinuar elemente dhe teknika të ndryshme artistike. • Përdor kompjuterin në dizajnim. • Bën stoli, bizhuteri, dekorime dhe dizajne.
<p>Shembuj të aktiviteteve</p> <ul style="list-style-type: none"> • Nxënësit dizajnojnë flamur me motiv ekopatullë, duke përdorur motive natyrore dhe ekologjike. Përdoren termat: formë, vijë dhe ngjyrë. Materiali artistik i përdorur - laps dhe marker. • Nxënësit dizajnojnë kopertinë për një libër me ilustrime. Përdoren termat: formë, ngjyrë, madhësi dhe hapësirë. Materiali artistik i përdorur - laps, ngjyra druri dhe marker. • Nxënësit bëjnë një ilustrim sipas një teksti që përpunohet në lëndën e gjuhës amtare. Përdoret: forma, madhësia dhe hapësira. Materiali artistik i përdorur - laps dhe ngjyra uji. • Nxënësit dizajnojnë me teknikën <i>Kolazh</i> me motiv veshje dimërore me materiale të ndryshme, si: tekstil, letër me ngjyra e të ngjashme. Përdoren termat: formë, madhësi dhe ngjyrë. • Nxënësit dekorojnë paketimin me temën Ecostandard me ndihmën e kolazhit me materiale të ndryshme natyrore. Përdoren termat: formë, ngjyrë, ton dhe sipërfaqe. • Nxënësit bëjnë/përdorin një shabllon kartoni dhe ngjyra tempere dhe printojnë grafika për motivin e festës. Bëhet një lidhje me termat: formë, madhësi, ngjyrë. • Nxënësit përdorin kompjuterin për të dizajnuar dhe printuar motiv - punimi i një kalendari të natyrës sipas udhëzimeve të dhëna paraprakisht. Bëhet një lidhje me termat: madhësi, formë, ngjyrë, sipërfaqe. • Nxënësit bëjnë shabllone prej kartoni që përdoren për të printuar një shall pranveror - pëlhurë për të marrë një model dekorativ, bëhet një lidhje me termat: madhësia, forma, ngjyra, toni, sipërfaqja. • Nxënësit printojnë duke përdorur teknikën <i>Frotage</i>: me laps kalojnë një fletë letre nën të cilën vendosen materiale të ndryshme me tekstura të ndryshme. Nëpërmjet kësaj teme bëhet një lidhje me termat: madhësi, formë, ton, sipërfaqe. • Nxënësit printojnë një monotip me ngjyra ose bardh e zi mbi një motiv me forma gjeometrike në një ritëm të caktuar. 	

GJITHËPËRFSHIRJA, BARAZIA GJINORE/NDJESHMËRIA, NDËRKULTURA DHE INTEGRIMI NDËRLËNDËOR

Mësimdhënësi/ja i/e siguron barazinë duke i përfshirë të gjithë nxënësit në të gjitha aktivitetet gjatë orës. Në këtë mënyrë ai/ajo mundëson që çdo fëmijë të jetë i angazhuar në mënyrë konjitive dhe emocionale nëpërmjet përdorimit të qasjeve të përshtatshme në mësimdhënie (individualizimi, diferencimi, puna në ekip, mbështetja mes nxënësve). Gjatë punës me nxënës me aftësi të kufizuara, zbatohet një plan arsimor individual (me rezultate të përshtatura të të mësuarit dhe standarde të vlerësimit) dhe çdo herë kur është e mundur të përdoret mbështetje shtesë nga individë të tjerë (asistentë personalë dhe arsimorë, ndërmjetësues arsimorë, tutorë vullnetarë dhe profesionistë nga shkollat e qendrave të burimeve). Vëzhgon rregullisht të gjithë nxënësit, veçanërisht ata të grupeve të ndjeshme, në mënyrë që të jenë në gjendje të identifikojnë vështirësitë e të mësuarit, për t'i inkurajuar dhe mbështetur ata në arritjen e rezultateve në mësim nxënie.

Gjatë realizimit të aktiviteteve, mësimdhënësi trajton si djemtë ashtu edhe vajzat në mënyrë të barabartë, duke u kujdesur që të mos u caktojë atyre role stereotipike gjinore. Gjatë formimit të grupeve të punës, bëhet një përpjekje për të siguruar ekuilibrin gjinor. Kur zgjidhni materiale shtesë në mësimdhënie, përdorni ilustrime dhe shembuj që janë të ndjeshëm ndaj aspektit gjinor, etnik/kulturor dhe inkurajojnë barazinë gjinore, d.m.th. që promovojnë ndërkulturën. Gjithashtu, mësimdhënësi kujdeset që të mos kalojnë stereotipe gjinore dhe etnike në punimet e nxënësve.

Çdo herë kur është e mundur, mësimdhënësi përdor integrimin e aktiviteteve/koncepteve nga lënda Arsim figurativ me përmbajtjet/standartet nga lëndët e tjera në planifikimin dhe realizimin e mësimdhënies. Në këtë mënyrë, kjo lëndë motivon nxënësit për të mësuar lëndë të tjera dhe ndihmon në përvetësimin më të lehtë të tyre.

VLERËSIMI I ARRITJEVE TË NXËNËSVE

Për t'iu mundësuar nxënësve të arrijnë standardet e pritura të vlerësimit, mësimdhënësi vazhdimisht vëzhgon aktivitetet e tyre gjatë mësimdhënies dhe mësimit. Mblidhen tregues për aktivitetet e tyre, motivimin për krijim artistik, angazhimin e nxënësve, përkushtimin në punë, punën individuale, në tandem dhe grupe. Për pjesëmarrjen në aktivitete, nxënësit marrin informata kthyesë të cilat tregojnë nivelin e suksesit në realizimin e aktivitetit/detyrës dhe jepen udhëzime për përmirësim (vlerësim formativ). Për atë qëllim, mësimdhënësi vëzhgon dhe vlerëson:

- përgjigjet me gojë për pyetjet e bëra nga ana e mësimdhënësit apo shokët/shoqet e klasës;
- aktiviteti praktik gjatë orës (pjesëmarrja në aktivitete);
- vepra të bëra arti (vizatim, pikturë, modelim dhe ndërtim plastik, printim dhe dizajn);

- pjesëmarrja në punimin e veprave të përbashkëta.

Gjatë vëzhgimit të arritjeve të nxënësve, mësimit duhet t'i kushtojë vëmendje të veçantë qasjes individuale për arritjet e secilit nxënës. Në fund të vitit kryhet një vlerësim përshkrues përmbledhës (sumativ) i standardeve të arritura për vlerësimin.

Fillimi i zbatimit të programit mësimor	Viti 2022/2023
Institucioni / Përfaqësues i programit	Byroja e Zhvillimit të Arsimit
Në pajtim me nenin 30 paragrafi 3 të Ligjit për arsimin fillor (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 161/19 dhe 229/20) Ministria e Arsimit dhe Shkencës miratoi programin mësimor për lëndën <i>Arsim figurativ</i> për klasën e II.	Nr. _____ Data _____ <div style="text-align: right;"> Ministria e Arsimit dhe Shkencës Milla Carovska _____ </div>